



AIDA

ALBANIAN INVESTMENT DEVELOPMENT AGENCY

invest in Albania

NEWSLETTER

JANAR – MARS 2023

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve boton numrin e parë të revistës për vitin 2023, për periudhën janar - mars.

AIDA ka kthyer në traditë botimin e revistës periodike tremujore. Çdo vit, Agjencia publikon 4 numra të newsletter-it me informacione të vlefshme për audiencën, grupet e interesit, bizneset dhe publikun më të gjerë. Në formatin e një buletini elektronik, ndarë në disa rubrika, revista pasqyron evente, takime, webinare, sesione informuese/info day, door to door, aftercare, trajnime, vizita, forume, panaire, bashkëpunime, botime e publikime, përditësime dhe informacione të rëndësishme mbi sipërmarrjen, nisma apo fushata të rëndësishme që AIDA ndërmerr. Secili nga numrat e revistës elektronike është njëherësh një dokumentim që përmbledh aktivitetet përgjatë 3 muajve dhe një burim informacioni, që shfaq profilin e konsoliduar të AIDA-s dhe fushave që ka në fokus.

AIDA zhvillon veprimtarinë e saj për të fuqizuar zhvillimin ekonomik të vendit, sidomos duke përkrahur prodhuesit dhe produktet vendase. Në funksion të një diplomacie ekonomike, Agjencia jep kontribut në zgjerimin e bashkëpunimit me vende partnere dhe strategjike nëpërmjet dialogut me institucione që kanë në fokus investimet, si dhe rolit aktiv dhe pjesëmarrjes së vazhdueshme në evente që kanë si objekt promovimin e Shqipërisë në fusha të ndryshme.

Mbështetja dhe asistimi profesional i investitorëve të huaj mbeten me prioritet të veçantë. Agjencia, përveç tërheqjes së investimeve direkte në vendin tonë, ndërmerr nisma për rritjen e konkurrencës mes Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme (NVM), zhvillimin e sektorit privat, përmirësimin e klimës së biznesit, për promovimin dhe ofrimin e ndihmës për eksportet e mallrave dhe shërbimeve, duke bashkëpunuar me subjektet e tregtisë së jashtme dhe organet shtetërore. Në ndihmë të bizneseve vendase dhe produkteve 'Made in Albania', AIDA vijon fushatën promovuese 'E Dua Shqip'.

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve është proaktive dhe ka si përparësi mbështetjen e interesave ekonomikë të Shqipërisë, tërheqjen e investimeve të huaja, promovimin e vendit si destinacion i veçantë dhe i qëndrueshëm turistik, si partner i besuar tregtar/i investimeve të huaja në sektorë potencialë si energjia, turizmi, infrastruktura, bujqësia etj., si dhe promovimin e produkteve dhe shërbimeve të markës shqiptare.

Për të rejtat më të fundit mbi Agjencinë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve vizitoni:

 aida__albania  AIDA - Albanian Investment Development Agency

 info@aida.gov.al  aidagoval  +355 (0)42 251 001  investinalbania

 AIDA - Albanian Investment Development Agency

FUSHATA PROMOVUESE DHE PROJEKTE

- > FUSHATA PROMOVUESE “ZGJIDH TË VENDIT”
- > PLATFORMA AKSES NË FINANCË
- > PLATFORMA “BUSINESS TO BUSINESS”



FUSHATA PROMOVUESE E PRODUKTEVE SHQIPTARE “ZGJIDH TË VENDIT”

AIDA, si një pikë qendrore për sipërmarrjen është gjithmonë në mbështetje të prodhuesve shqiptarë, të cilët gjithnjë e më shumë po shtojnë produkte nën markën “Made in Albania”, duke ofruar për tregun vendas dhe atë të huaj cilësinë dhe vlerat tona tradicionale. E Dua Shqip është fushata promovuese e Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve/AIDA në mbështetje të bizneseve shqiptare dhe produkteve ‘Made in Albania’. Qëllimi ynë është të njohim, zgjedhim dhe duam çdo ditë produktet shqiptare.

T’i japim jetë artizanatit, produkteve autentike dhe unike duke bërë bashkë çdo copëz që ndërton historinë e Shqipërisë me vlera. Kjo nismë synon të krijojë një katalog sa më të plotë dhe gjithëpërfshirës. Nëse jeni një biznes apo artizan, prodhoni të mira nga duart tuaja, doni t’i prezantoni dhe t’i ktheni në një “atraksion turistik” për vendin e origjinës, na dërgoni përshkrimin dhe fotografitë e produktit. Rrënjët janë të rëndësishme. Nëse dëshironi të bëheni pjesë e kësaj fushate, na kontaktoni në info@aida.gov.al ose në numrin e telefonit 04 225 1001.

[LINK](#)



AIDA përkrah produktet shqiptare

zëjdh të vendit

Dri'art Company

Dri'art Company është biznes i themeluar në dhjetor 2021, për prodhimin e qirinjëve 100% organike. Kjo sipërmarrje lindi nga dashuria për natyrën dhe kujdesin ndaj shëndetit, duke krijuar një produkt natyral, i përbërë vetëm nga dylli i bletëve dhe të punuara në mënyrë artizanale. Djegia e këtyre qirinjëve pastron ajrin duke lëshuar jone negative dhe pasuruar me propolis. Kompania prodhon qirinjë të formave dhe përmasave të ndryshme për ambiente familjare apo evente, në bazë të kërkesës së klientëve.

E duam shqip dhe zgjedhim tonën në: 068 204 4050.



AIDA përkrah produktet shqiptare

zëjdh të vendit

Erëzat "Maester Chef"

Kompania "Maester Chef" u themelua në vitin 2015, me qëllim që t'i ofronte tregut Shqiptar dhe më gjerë një gamë të re të përdorimit të erëzave. Për prodhimin e produkteve kompania përdor bimët aromatike dhe medicinale 100 % natyrale të vendit tonë dhe të certifikuara. "Maester Chef" ofron në treg produkte të një cilësie shumë të lartë dhe nga më të larmishmet, si në shije, ashtu dhe në paketime praktike.

E duam shqip dhe zgjedhim tonën në: info@maesterchef.al ose 069 377 7774.



AIDA përkrah produktet shqiptare

zëjdh të vendit

"Kantina Herta"

"Kantina Herta" është një sipërmarrje e familjes Hamdi Osmani, në Maminas të Durrësit, me një sipërfaqe prej 6 hektarësh. Kantina ka hedhur në treg produkte si: Bukuroshja e Maminasit, Merlot Dyrrah, Kabënet Savinjon, Merlot Trebiano, Raki Rrushi, Raka e Shefit, etj...

Teknologjia e saj italiane "Della Tofolla", i jep mundësinë kësaj kantine të prodhojë verëra të cilësisë së lartë dhe të jetë një konkuresore e denjë në tregun e verërave shqiptare.

E duam shqip dhe zgjedhim tonën në: kantinaherta@outlook.com ose 068 679 7703.



AIDA përkrah produktet shqiptare

zëjdh të vendit

"ENES Company"

"ENES Company" e themeluar në vitin 1992, në Tiranë, sjell në treg eksperiencën 30-vjeçare në prodhimin dhe tregtimin e produkteve të aluminit dhe atyre plastike për përdorim shtëpiak dhe profesional. Aktualisht, në portofolin e kompanisë janë mbi 40 produkte plastike Made in Albania, game e cila pasurohet vazhdimisht me produkte të reja dhe të denja për tregun shqiptar dhe atë ndërkombëtar. Qëllimi i kompanisë është: Klienti të kenauqur në çdo cep të Shqipërisë.

E duam shqip dhe zgjedhim tonën në info@enes.al ose +355 67 506 0605



AIDA përkrah produktet shqiptare

zëjdh të vendit

Produktet "ZDRAVA"

Zdrava Group është një kompani 100% shqiptare, e themeluar në vitin 1992, në industrinë e përpunimit të fruta-perimeve. Në vitin 2016, kompania zgjeroi aktivitetin, duke hapur një fabrikë për prodhimin e koncentratit të domates, si dhe nënproduktet e saj. Kompania ofron produkte cilësore dhe brenda standardeve Europiane të sigurisë ushqimore. Zdrava Group është një ndër kompanitë më të mëdha të eksportit të produkteve "Made in Albania", në të gjithë Ballkanin, Europën dhe së fundmi edhe në SHBA.

E duam shqip dhe zgjedhim tonën në: info@zdravagroup.com ose 069 207 4479.



AIDA përkrah produktet shqiptare

zëjdh të vendit

M&D Handmade Cosmetics

Kompania M&D, me një eksperiencë 10-vjeçare në tregun shqiptar, operon në prodhimin e produkteve të sigurta dhe të shëndetshme të kujdesit personal, me produkte totalisht bimore. Të gjitha lëndët e para të përdorura nga M&D, janë të certifikim Bio. Kompania M&D është e përkushtuar në krijimin e produkteve me përbërës natyralë siç janë: qumështi i gomaricës, vaj ulliri, vaj kokosi, vaj palme, vaj ricini, aloe vera, etj.

E duam shqip dhe zgjedhim tonën në: info@produktenatyrale-m-d.com ose 068 885 4294.



zojdh të vendit

"GM Premium Leather"

"GM Premium Leather" është një biznes i themeluar në vitin 2021, por i krijuar nga një familje me traditë të hershme në sektorin e fasonerisë. Falë njohurive dhe eksperiencës, ndërthurur me pasionin, "GM Premium Leather" prezantoi në Shqipëri disa produkte të suksesshme lëkure, 100% Made in Albania. Kompania synon gjithashtu që të shtrijë veprimtarinë edhe jashtë vendit, duke përcjellë po të njëjtat vlera dhe siguruar gjithmonë një standard të lartë cilësie.

E duam shqip dhe zgjedhim tonën në: gerimani95@gmail.com ose në 068 403 3303.

AIDA



zojdh të vendit

Uthulla "Frutal"



Frutal Uthull Molle

Nga Agrofarm d

Kompania "Agro Fruit" nisi fillimisht si një punishte e vogël në qytetin e Korçës që merrej me përpunimin e mollës jeshile, për të vijuar më pas me prodhimin e uthullës në vitin 2010. "Agro Fruit" ka zgjeruar gamën e prodhimit të llojeve të uthullës, si edhe prodhimin e lëngjeve të frutave të freskëta 100% natyrlë. Produktet e "Agro Fruit" janë jo vetëm të preferuara në tregun vendas, por edhe eksportohen në shumë vende të tjera të botës.

E duam shqip dhe zgjedhim tonën në: vasilbraholli@hotmail.com ose 067 481 8402.



zojdh të vendit

Sapunët artizanale "ZaDream"

Pesë vite më parë, Laureta Lemezhi themeloi punishten "ZaDream" në Blinisht, Lezhë. Kjo punishte është e specializuar në prodhimin e sapunëve artizanale, 100% natyral, të përbërë nga bimët medicinale dhe aromatike.

Gjithashtu, për prodhimin e sapunëve përdoret edhe vaj i ullirit bio dhe dyll i bletës. Sapunët "ZaDream" përvëq pastrimit kanë edhe efektin e kurimit të sëmundjeve të lëkurës.

E duam shqip dhe zgjedhim tonën në: lauretalemzhi@gmail.com ose 069 966 5437.



invest in Albania



AKSES NË FINANCË, PLATFORMA UNIKE PËR FINANCIMIN E BIZNESEVE



Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve mirëmban dhe përditëson me skema të reja financiare platformën “Akses në Financë”, duke ofruar informacionin më të fundit mbi mundësitë dhe burimet financiare për NVM-të në Shqipëri. AIDA kujdeset, që thirrjet e publikuara në platformë <https://aida-smefinance.gov.al/> të përmbajnë të dhënat thelbësore dhe të jenë shteruese në përcjelljen e informacionit, për të orientuar një aplikim të suksesshëm dhe për të përmbushur në këtë mënyrë misionin për mbështetjen e biznesit vendas.

[LINK](#)

PROGRAMI I INOVACIONIT EXPO LIVE

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA), vijon mbështetjen e ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme nëpërmjet platformës “Akses në Financë”. Në këtë platformë mund të gjeni thirrjen më të re të publikuar “Programi i Inovacionit Expo Live”.

[LINK](#)



THIRRJA “SURE5.0” NË PLATFORMËN AKSES NË FINANCË

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve, njoftoi hapjen e thirrjes SURE5.0, një program akselerues për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (NVM).

Ky program i financuar nga Bashkimi Europian do të shpërndajë fondin prej 2.6 ml EUR, për të ndihmuar procesin e transformimit digjital të bazuar në parimet e Industry 5.0.

Aplikimet në këtë thirrje do të pranohen nga ndërmarrje që duke zbatuar parimet e Industry 5.0, dëshirojnë të arrijnë një model biznesi më të qëndrueshëm dhe elastik, si dhe që operojnë në industritë:

- Transport dhe automobilistikë;
- Hapësirë ajrore dhe mbrojtje;
- Elektronikë

Fondi do të shpërndahet në dy faza të ndryshme të cilat do të zhvillohen njëra pas tjetrës.



Funded by the European Union

Acceleration Programme

Opened from December 15 2022 until March 1 2023

Find more at www.sureproject.eu

[LINK](#)

PLATFORMA "BUSINESS TO BUSINESS"

Në web faqen e Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve, (AIDA) është e publikuar platforma "Business to Business", (B2B) që ju vjen në ndihmë NVM që veprojnë në Shqipëri. B2B është një rrjet aktiv, i cili ofron mundësinë për bashkëpunime dhe investime të suksesshme midis bizneseve. Kjo platformë është një "mekanizëm" lehtësues që krijon mundësi për bashkëpunime frytdhënëse dhe për të zgjeruar kontaktet në botën e biznesit. AIDA, ju fton të regjistroheni ose përditësoni të dhënat tuaja në platformën B2B, duke na kontaktuar në adresën zyrtare: info@aida.gov.al

[LINK](#)

INVESTIMET STRATEGJIKE DHE TË HUAJA NË SHQIPËRI

AIDA VIZITOI KOMPANINË "EVEREST SHPK" NË BASHKINË KAMËZ

AIDA, përfaqësuar nga stafi i sektorit të Investimeve & Aftercare, përmes mbështetjes së qeverisë Gjermane nëpërmjet GIZ/ProSEED 2.0, në bashkëpunim me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, si dhe të shoqëruar nga përfaqësues të Bashkisë Kamëz, më datë 25 janar 2023, kanë vizituar kompaninë "Everest Shpk", e vendosur në Bashkinë Kamëz.

EVEREST e krijuar prej vitit 1997, është një nga kompanitë kryesore të prodhimit të profileve të aluminit në Evropë, që angazhohet në projektimin, prodhimin dhe tregtimin e profileve të aluminit, dritareve, dyerve dhe fasadave, si dhe aplikimeve të tjera arkitekturore.



Kompania operon në tregun vendas, por ka arritur gjithashtu të ekportojë në SHBA, Kanada, Kosovë, Maltë, Maqedoni e Veriut, Itali, etj. Ajo është fituese e çmimit "Kompania e parë ndërtuese në Shqipëri", si dhe mban vendin e parë nga kompanitë shqiptare me eksportin e aluminit në vlerën më të madhe për vitin 2022.

Synimi i takimit ishte konsolidimi i bashkëpunimit midis biznesit, AIDA-s dhe qeverisjes lokale, gjithashtu dhe diskutimi i nevojave apo problematikave të ndryshme që mund të kenë hasur. Kompania si sugjerim primar përcolli nevojën e mbështetjes për pjesëmarrje në panairët ndërkombëtare për bizneset që duan të marrin pjesë, si forma më e mire sipas tyre për promovimin e mundësive të Shqipërisë dhe produkteve shqiptare.

SHPREHJE INTERESI PËR BASHKËPUNIM NGA KOMPANIA BULLGARE INFINITY LTD

AIDA njoftoi se kompania bullgare Infinity Ltd, ka shprehur interes në ofrimin e shërbimeve/ produkteve dhe në krijimin e partneriteteve, si dhe bashkëpunimeve të mundshme në tregun potencial shqiptar, me qëllim zgjerimin e kompanisë më gjerë në rajon.

Infinity Ltd operon në partneritet me mbi 70 kompani, ndër të cilët përmendim: DeciveLock, Blacco, DataLocker, Acronis, Panasonic, CYCLOPE, Vicarius, Galaxkey etj. Aktiviteti i tyre ka për qëllim projektimin, furnizimin, zbatimin dhe mirëmbajtjen e zgjidhjeve të specializuara software dhe hardware për mbrojtjen e informacionit të ndjeshëm të organizatës, rrjeteve të korporatave dhe sistemeve të automatizuara të informacionit.



Ftohen të gjitha kompanitë, organizatat, subjektet shqiptare të interesuara për zgjidhjet dhe shërbimet që kjo kompani ofron, të paraqesin interesin e tyre në adresën zyrtare: info@aida.gov.al.

AKTIVITETE DHE PANAIRE

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA), publikoi paraprakisht kalendarin e panaireve më të rëndësishëm kombëtare dhe ndërkombëtare, që do të zhvillohen përgjatë vitit 2023.

AIDA ftoi të gjitha bizneset shqiptare, të marrin pjesë në keto panaire, duke ofruar mbështjen ndaj tyre, për një prezantim sa më dinjitoz për kompaninë dhe produktet që ato përfaqësojnë.

Panairët janë një vlerë e shtuar për zhvillimin e biznesit dhe gjetjen tregjeve të reja. Këto panairë janë të ndara sipas seksioneve përkatëse, ku informimi i bizneseve të interesuara është më i thjeshtë për marjen e informacioneve.

[LINK](#) [LINK](#)



NJOFTIME MBI PANAIRET DHE AKTIVITETET



AIDA ORGANIZOI PJESËMARRJEN E KOMPANIVE SHQIPTARE NË PANAIRIN “FOOD EXPO 2023”

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA), me mbeshtetjen e #SIPPO (Swiss Import Promotion Programme), organizoi pjesëmarrjen e pesë kompanive shqiptare në panairin më të madh të ushqimeve dhe pijeve në Evropën Juglindore “FOOD EXPO 2023”, Greqi. Kompanitë shqiptare si: Birra Korça Sh.p.k, Biobes Sh.p.k, Salvia Produkte Natyrore Sh.p.k, Enofama Sh.p.k, Bidaj Sh.p.k, ekspozuan dhe promovuan produktet Made in Albania gjatë 3 ditëve të panairit.

Pjesëmarrja në “FOOD EXPO 2023” krijoi mundësi për bashkëpunime dhe shtrirje në tregjet e huaja, si edhe lidhjen e kontratave të reja mes kompanive pjesëmarrëse.




“ENERGY EXPO & FORUM 2023”



Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA), ftoi të bëheni pjesë e Edicionit të 5-të të Panairit dhe Forumit Ndërkombëtar të Energjisë “Energy Expo & Forum 2023”, në datat 29-31 Mars 2023, e organizuar nga Expocity Albania

”Energy Expo & Forum 2023”, kishte në fokus politikat energjetike dhe aspektet ligjore në Shqipëri dhe rajon, orientimin dhe konsolidimin e planit kombëtar të energjisë, sfidat e bashkëpunimit rajonal të tregjeve, risitë, skemat mbështetëse që ofrohen nga qeveritë për promovimin e investimeve në këtë fushë, etj.

EKSPOZITA E 3-TË MES KINËS DHE VENDEVE TË EVROPËS QENDRORE DHE LINDORE



AIDA, njoftoi që në datat 16-20 maj 2023, do të zhvillohet Ekspozita e 3-të mes Kinës dhe Vendeve të Evropës Qendrore dhe Lindore, me temë "Bashkëpunimi i thelluar për një të ardhme të përbashkët", që do të mbahet në Ningbo, Kinë.

Ekspozita do të përbëhet nga 20 ngjarje kryesore dhe me një sipërfaqe prej 210 mijë m², do të ekspozohen produkte nga fusha e teknologjisë së avancuar, bujqësisë, kozmetikës, turizmit, logjistikës, kulturës, etj., nga vendet e EQL, vendet evropiane dhe nga 31 provincat e Kinës.

Aktivitetet që do të mbahen gjatë ditëve të ekspozitës do të krijojnë mundësinë për të forcuar dhe krijuar bashkëpunime të reja, për të njohur risitë dhe zgjidhjet më të fundit inovative.

[LINK](#)

PANAIRI “DITËT E BUJQËSISË 2023”



Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA), ju fton të bëheni pjesë e panairit “Ditët e Bujqësisë 2023”, Panairi Ndërkombëtar dedikuar Bujqësisë së Qëndrueshme, Blegtorisë, Peshkimit dhe Inovacionit, që do të mbahet në datat 27-29 Prill 2023, në Lushnjë, i organizuar nga Iceberg Exhibitions.

Në panair do të marrin pjesë aktorët më të rëndësishëm të sektorit të bujqësisë, blegtorisë, peshkimit nga Shqipëria, rajoni i Ballkanit dhe Evropa. “Ditët e Bujqësisë 2023”, do të ofrojë mundësi të shkëlqyera për bizneset dhe profesionistët pjesëmarrëse.

[LINK](#)

EVENTI “BIO FESTIVAL”



Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA), njoftoi që në datat 06 - 08 maj 2023, do të zhvillohet në Greqi, event i “BIO FESTIVAL”, i fokusuar në produktet 100% natyrale dhe jetën e shëndetshme. Ky event do ju mundësojë ekspozuesve të prezantojnë produktet dhe shërbimet përpara qindra vizitorëve, arrijnë marrëveshje të rëndësishme tregtare, si edhe zgjerojnë rrjetin e shpërndarjes së produkteve.

Pjesëmarrësit në “BIO FESTIVAL”, do të informohen për tendencat dhe zhvillimet më të fundit në industrinë ushqimore dhe fitojnë njohuri më të mira për ushqimin organik dhe kulturën e ushqimeve bio.

[LINK](#)

"BASIS SOFT EXPO 2023"



Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA), njoftoi se në datat 23-26 shkurt 2023, Shoqata e Shërbimeve të Softuerit dhe Informacionit të Bangladeshit (BASIS), organi më i lartë i biznesit në sektorin TIK, organizoi një nga kongreset më të mëdha rajonale të teknologjisë "BASIS SoftExpo 2023".

[LINK](#)

EKSPOZITA "INNOTECH 2023"



AIDA, njoftoi se në datat 29-30 Mars 2023, do të orgnizohej Konferenca dhe Ekspozita Ndërkombëtare për Inovacionin "INNOTECH 2023", në Tel Aviv, Izrael.

"INNOTECH" kishte si qëllim të ofronte një platformë efektive biznesi, ku ekspozuesit të treguan aftësitë e tyre teknologjike në fushat e kibernetikës, inteligjencës artificiale, Cities Smart mobility, Fintech, DeepTech, sistemeve autonome, etj.

"INNOTECH" ishte një mundësi unike për pjesëmarrësit për të forcuar dhe krijuar lidhje të reja ndërkombëtare dhe për të njohur risitë dhe zgjidhjet më të fundit të komunitetit ndërkombëtar të inovacionit.

PANAIRI “BEYOND 2023”



Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA), njoftoi se në datat 24 – 26 maj 2023 do të zhvillohet Panairi Ndërkombëtar për Inovacionin dhe Teknologjinë “BEYOND 2023” në Selanik, Greqi.

V

Ky event do të shërbejë si platforma kryesore në rajonin e Evropës Juglindore, Mesdheut dhe rajonit MENA në sektorin e teknologjisë dhe kompanive inovative.

[LINK](#)

PANAIR “ARTOZA”



AIDA, njoftoi se në datat 3 - 6 mars 2023, do të mbahej Panairi Ndërkombëtar në sektorin e prodhimeve të brumit dhe ëmbëlsirave “ARTOZA”, në Athinë, Greqi. Ky panair do të shërbente si një platformë që nxiste inovacionin dhe zhvillimet, jo vetëm në sektorin e prodhimeve të brumit dhe ëmbëlsirave, por edhe në industrinë ushqimore më gjerë.

“ARTOZA” do të mblidhte përfaqësues të bizneseve të furrave të bukës, ëmbëlsirave, por edhe përfaqësues të bizneseve nga industria e hotelierisë dhe shërbimeve ushqimore.

EKSPOZITA NDËRKOMBËTARE E MAKINERIVE TË RËNDA "HEAVY MAX"



Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve njoftoi që në datat 29 maj – 1 qershor 2023, do të organizohet Ekspozita Ndërkombëtare e Makinerive të Rënda "Heavy Max", në Doha, Katar. "Heavy Max" do të bëjë bashkë tregtarë, furnitorë, prodhues, agjentë dhe inxhinierë të industrisë së makinerive të rënda, të markave më të mira, nga shumë vende të botës.

Kjo ekspozitë do të shërbejë edhe si një platformë komunikimi dhe informacioni, e cila do t'ju ofrojë kompanive ekspozuese mundësinë që të prezantojnë produktete e tyre para një auditori ekspertësh.

[LINK](#)

"REBUILD UKRAINE 2023" 15-16 SHKURT, VARSHAVË, POLONI



AIDA njoftoi se në datat 15-16 shkurt 2023, do të organizohet Ekspozita dhe Konferenca Ndërkombëtare "ReBuild Ukraine 2023", në Varshavë, Poloni. Kjo ekspozitë synonte të bashkonte dhe paraqeste para audiencës oferta qeveritare, ndërkombëtare dhe sociale për të rivendosur dhe zhvilluar komunitetet lokale ukrainase të dëmtuara gjatë luftës.

"ReBuild Ukraine 2023" do të shërbente si një platformë, ku do të shkëmbeheshin informacione midis komuniteteve të biznesit dhe partnerëve potencialë, ndërgjegjësuar për mundësitë ekzistuese të investimeve në Ukrainë, tërheqjen e investitorëve për të krijuar ndërmarrje të reja dhe zhvillimin e tregtisë midis vendeve.

[LINK](#)

12TH INTERNATIONAL MEETING OF YOUNG BEESKEEPERS”



AIDA, njoftoi se në datat 03 - 07 korrik 2023, në Slloveni, do të zhvillohet aktiviteti ndërkombëtar i bletarëve të rinj “12th International Meeting of Young Beekeepers”, e organizuar nga Shoqata sllovene e bletareve.

Qëllimi i aktivitetit është të rrisë dhe zhvillojë një brez të rinjsh bletarë, t'i ofrojë njohuritë më të fundit bletarëve të rinj, si dhe t'i ndihmojë të rinjtë që e duan këtë profesion me aftësitë e mbajtjes dhe të kuptuarit të bletëve. Aktiviteti do të zhvillohet në formën e konkursit, ku ekipet do të formohen në bazë të shteteve pjesëmarrëse, të cilat do të gjykojnë dhe vlerësohen si ekip, si edhe individualisht.

Për më shumë informacion mbi mënyrën dhe afatet e regjistrimit, tarifën e pjesëmarrjes, si dhe çdo informacioni tjetër të nevojshëm, vizitoni linkun:

[LINK](#)

KONKURSI I FORUMIT TË INVESTIMEVE TË DHOMËS SË BALLKANIT PERËNDIMOR 6



Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA), ftoi kompanitë e vogla dhe të mesme shqiptare të bëheshin pjesë e konkursit të Forumit të Investimeve të Dhomës së Ballkanit Perëndimor 6, me temë: “Programi i asistencës teknike për hyrjen në tregjet europiane dhe botërore”.

Aktiviteti zhvillohej me rastin e pesë vjetorit të themelimit të Tregut të Përbashkët Rajonal për gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor, i organizuar nga Forumi i Investimeve i Dhomës së Ballkanit Perëndimor 6 (WB6 CIF), me mbështetjen e Komisionit Europian.

[LINK](#)

PANAIRI I HOTELERISË “XENIA”



Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA), njoftoi që në datat 25-27 nëntor 2023, do të zhvillohet panairi i hotelerisë “XENIA”, në Athinë, Greqi. Kompanitë ekspozuese do t’i përkasin kategorive si: ndërtim, dekor, energji, automatizim, pajisje hotelerie, makineri dhe pajisje kuzhine, ushqim dhe pije, si dhe teknologji dixhitale.

Në këtë panair profesionistët nga sektori i hoteleve do të kenë mundësinë të kontaktojnë me kompanitë lidere që ofrojnë pajisje hoteliere, zgjidhje teknologjike dhe shërbime online, kompani të specializuara në ndërtim, rinovim etj.

[LINK](#)

PANAIRI I BUJQËSISË “MACFRUT 2023”



Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA), informoi se në datat 03 – 05 Maj 2023, do të zhvillohet panairi “MACFRUT 2023”, në Rimini - Expo Center, Itali.

Panairi “MACFRUT 2023” është një ekspozitë që përfaqëson të gjithë zinxhirin e furnizimit, me 9 sektorë të përfshirë: Prodhimi dhe Tregtia, Makineritë dhe Bimët, Paketimi, Makineritë Bujqësore, Sistemet e Ujitjes, Erëzat dhe Bimët, Farërat, Biostimulantët, Logjistika dhe Shërbimet.

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve planifikoi pjesëmarrjen në këtë panair me kompani të sektorëve që ky organizim mbulon.

[LINK](#)

“INTERTEX PORTUGAL 2023”



Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA), njoftoi që në datat 31 maji - 02 qershor 2023, do të organizohet “Intertex Portugal 2023”, Panairi Ndërkombëtar i Industrisë së Tekstilit, i cili do të mbahet në Portugali.

“Intertex Portugal 2023”, i cili përfshin të gjitha produktet dhe shërbimet e tekstilit, do të bëjë bashkë profesionistët dhe prodhuesit më të mëdhenj dhe rëndësishëm të këtij sektori. Kompanive ekspozuese do ju jepet një mundësi unike eksporti, së bashku me aksesin në rrjete të reja dhe bashkëpunime biznesi.

[LINK](#)

PANAIRI I SHËRBIMEVE TË EKSPORTIT "GO INTERNATIONAL"



Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA), njoftoi që në datat 11 - 12 tetor 2023, do të organizohet panairi i shërbimeve të eksportit "Go International" në Fiera Del Levante, në Milano. Në këtë panair do të jenë të pranishëm më shumë se 100 ekspozues dhe një program i ngjeshur konferencash, kushtuar prezantimit të mundësive të biznesit të ofruara nga tregjet kryesore të huaja dhe të rejtat më të fundit mbi shërbimet e eksportit.

Në panairin “Go International” do të bëhen pjesë si ekspozues: banka, menaxherë të përkohshëm të eksporteve, operatorë ndërkombëtarë të logjistikës, transportues, kompani të certifikimit të konformitetit, kompani sigurimesh kredie eksporti, firma ligjore ndërkombëtare, konsulentë eksporti, platforma për tregtinë elektronike ndërkombëtare, agjenci promovuese të vendeve të huaja, etj.

[LINK](#)

EKSPOZITA “WINE&SPIRITS SHOW 2023”



Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA), njoftoi që në datat 20-22 prill 2023, do të mbahej në Sofje, Bullgari, Ekspozita “Wine&Spirits Show 2023”.

Qëllimi kryesor i kësaj ekspozite ishte promovimi dhe prezantimi i pijeve tradicionale nga vendet pjesëmarrëse, pijeve me histori dhe teknologji të veçantë, llojeve të ndryshme të verërave, si dhe traditat dhe kultura e konsumimit të këtyre pijeve.

[LINK](#)

PANAIRI I TEKSTILEVE NË LONDËR



AIDA njoftoi që në datat 4-5 shtator 2023, do të zhvillohet Panairi i Tekstileve në Londër. Ky është panairi kryesor i industrisë së tekstileve në Mbretërinë e Bashkuar, ku ekspozohen pëlhura të modës, aksesore, dizajn printimi dhe veshje vintage.

Panairi i Tekstileve në Londër është një platformë ideale për t'u takuar me stilistë, blerës dhe prodhues, për të gjithë zinxhirët kryesorë të shitësve të veshjeve për meshkuj dhe femra, si edhe ekspozimit ndaj blerësve dhe stilistëve britanikë më me ndikim.

[LINK](#)

CEFTA LEHTËSON EKSPORTIN NËPËRMJET ZBATIMIT TË RREGULLAVE KALIMTARE QË NGA 1 SHKURTI



Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA), njoftoi së nga data 1 shkurt 2023, palët e CEFTA- s do të fillojnë zbatimin e rregullave kalimtare për origjinën preferenciale të mallrave, krahas rregullave të Konventës Pan-Euro-Mesdhetare (PEM).

Rregullat e reja do të jenë më fleksibël, duke synuar reduktimin e kostove administrative, thjeshtuar sistemin, thjeshtuar përcaktimin e origjinës së mallrave, të cilat do të lehtësojnë më tej tregtinë në CEFTA dhe me BE-në, si edhe mundësojnë kompanive të bëhen më konkurruese në këto tregje.

[LINK](#)





PUBLIKIMET E REJA TË AIDA-S

INVESTIMEVE TË HUAJA DIREKTE PËSUAN RITJE PËR 9 MUJORIN JANAR – SHTATOR 2022

Sipas të dhënave të Bankës së Shqipërisë, vendi ynë ka pësuar një rritje të Investimeve të Huaja Direkte, me 35% ose 255 milionë euro, për 9 mujorin Janar – Shtator 2022, duke arritur vlerën 984 milionë euro.


Burimi kryesor i hyrjeve të fluksit të IHD-ve ishte nga sektorët: Industrisë nxjerrëse; Aktiviteteve të pasurive të paluajtshme; Aktiviteteve financiare dhe të sigurimit; Industrisë përpunuese; Energjisë elektrike, gazit, furnizimit me ujë; si dhe i Tregtisë me shumicë dhe pakicë.

Burimi: BSH

NEWSLETTER KORRIK - SHTATOR 2022

35%

më shumë investime
të huaja direkte



PROJEKTI “CONNECTIT 2.0”

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA), ftoi të gjitha ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme (NMVM), të marrin pjesë në projektin “ConnectIT 2.0”, që nxit bashkëpunimin mes universiteteve dhe sektorit privat. Ky projekt është i mundur dhe mbështetur nga qeveria Gjermane nëpërmjet GIZ Shqipëri, programi ProSeed dhe EU4Innovation, në bashkëpunim me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë.



“ConnectIT 2.0” do të ofrojë asistencë teknike për zgjidhje dixhitale e novatore që mund të përmirësojë proceset dhe produktet e biznesit të tyre.

[LINK](#)

28 JANARI - DITA E MBROJTJES SË TË DHËNAVE PERSONALE DHE NË BOTË NJIHET SI DITA E PRIVATËSISË

Mbrojtja e të dhënave personale të njeriut është një e drejtë themelore dhe vlera e së cilës është thelbësore për funksionimin e një shteti demokratik.

Njohja, ndërgjegjësimi dhe promovimi në tërësi i të drejtave dhe lirive themelore të individit është një nga detyrat kryesore të çdo autoriteti publik për forcimin e vetëdijes qytetare. Mbrojtja e të dhënave personale është shumë e rëndësishme dhe në themel të zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik.





invest in Albania

